



## Takohet Komiteti për Administrimin e Tokës

Me qëllim të koordinimit, këshillimit dhe vendimmarrjes në fushën e administrimit të tokës dhe infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore, Agjencia Kadastrale e Kosovës në periudha periodike organizon takimin e komitetit ndërmëtor për administrimin e tokës. Ndërsa, takimi i fundit i këtij Komiteti u mbajt gjatë muajit prill, me pjesëmarrjen e niveleve më të larta institucionale të shënuar ndonjëherë, respektivisht me pjesëmarrjen Ministrin të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z. Fatmir Matoshit, Ministrin të Ministrisë së Administratës Publike z. Mahir Jagcilar, Sekretarin e Përgjithshëm i MMPH z. Arben Çitaku, Zv. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë z. Fadil Nura, Zv. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Mevludin Krasniqi, Zv. Ministri i Ministrisë së Financave z. Hyzer Gashi, Zv. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z. Beqir Fejzullahu, si dhe donatorët si Banka Botërore, Kartverket (Norvegji), USAID, JICA, UN HABITAT, Zyra e BE-së në Kosovë, etj. Me këtë rast ministri Matoshi, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës njih peshën e administrimit të tokës si nga aspekti i zhvillimit ekonomik po ashtu edhe nga aspekti i mirëqenies sociale për secilin qytetar të Republikës së Kosovës pa dallim gjinie, gjuhe apo etnie. "Pikërisht për këtë arsye, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe agjencive të saj vartëse ofron tërë potencialin e saj në avancim të administrimit të tokës,

duke u përpjekur të ndjek trendet në shtetet e zhvilluara përmes avancimit të legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve profesionale, avancimit të teknologjisë së informacionit dhe përmes investimeve kapitale", tha Matoshi. Ministri Matoshi tha se rezultatet e kësaj përkrahjeje kanë qenë konkrete dhe të prekshme si për qytetarët po ashtu edhe për institucionet. "Tatimi i tokës, sistemi i unifikuar i adresave, regjistra të sigurt pronësorë, investime në bujqësi, mjedisit më të shëndetshëm, infrastrukturë e zhvilluar rrugore, shkëmbin më të shpejtë e me të sigurt i të dhënave, ofrimi i shërbimeve të ndryshme publike janë disa nga fushat ku po shënohet avancim konkret", deklaroi Matoshi. I pari i MMPH-së, u ofroi mbështetje Agjencisë Kadastrale të Kosovës ndërsa tha se çdo rekomandim i tyre dhe i donatorëve ndihmon dhe lehtëson politik-bërjen dhe vendimmarrjen. Ndërsa ushtruesi i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, tha se bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të akterëve, është një strategji e qartë dhe e nevojshme gjatë zhvillimit të administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. "Administrimi i tokës po hynë në një fazë më dinamike. Kjo fazë dhe dinamikë kërkon nga ne që të ndryshojmë shumëçka si në aspektin e koordinimit të aktiviteteve, të avancimit profesional, të avancimit të legjislacionit, të shërbimeve, të ofrimit të produkteve me kualitet sa më të lartë, ngritjen e kualitetit të të dhënave ekzistuese, avancimin në

mënyrën e shpërndarjes së të dhënave si dhe avancimin në aspektin e teknologjisë informative", deklaroi Ahmeti. Pas disa prezantimeve profesionale dhe debateve interaktive, në takim u konkludua se ndërlikohja e sistemeve të ndryshme në fushën e administrimit të tokës do ngriste shkallën e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve në këtë fushë, u tha se është imediate vertiklizimi i sistemit kadastral, u theksua nevoja për shtyrje para të Ligjit të ri për kadastrë, e ngjashëm.

### AKK PRET DONATORËT

Me qëllim të koordinimit të donatorëve të përfshirë në administrimin e tokës në përgjithësi, si dhe në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në veçanti, gjatë muajit prill 2019 në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur takimi i rregullt i donatorëve. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i aktiviteteve të ndryshme të donatorëve dhe përkrahësve të AKK-së me qëllim të ngritjes së shkallës së transparencës, shmangien e mundësive për duplikimin të projekteve, diskutim mbi rezultatet e projekteve të arritura si dhe diskutim rreth sfidave me të cilat ballafaqohet administrimi i tokës. Në takimin e udhëhequr nga kreu i AKK-së z. Avni Ahmeti, përmes prezantimeve profesionale u prezantuan në detaje të arriturat e AKK-së ndërsa fokus i veçantë iu kushtua projekteve të ardhshme të AKK-së, (vazhdon në faqen 2)

të parapara për tu realizuara si përmes financimit të buxhetit të Republikës së Kosovës po ashtu edhe përmes financimit nga projekti REGIP i Bankës Botërore dhe donatorëve nga autoriteti norvegjez për kadastër dhe hartografi "Kartverket", JICA japoneze, SIDA suedeze etj. Ndërsa si sfida që duhen tejkaluar me qëllim të realizimit të suksesshëm të projekteve u ngrit nevoja për shtim të numrit të punëtorëve profesional në AKK dhe shtyrja para e ligjit të ri për kadastër i cili do të ristrukturonte sistemin kadastral në Kosovë. Përndryshe në takim morën pjesë përfaqësues të Bankës Botërore, JICA-s japoneze, "Kartverket" norvegjez, GIZ-it gjerman, etj.

## Publikohen ortofotot urbane 2018

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka prodhuar ortofotot e reja për tërë territorin e Republikës së Kosovës me rezolucione të ndryshme, duke përfshirë rezolucionin 8cm për zonat urbane, rezolucioni 20 cm për zonat rurale, rezolucioni 40cm për zonat malore dhe rezolucioni 40cm për një gjerësi 200 m jashtë kufirit. Përndryshe ortofotot e fundit në Kosovë ishin prodhuar në vitin 2012, andaj për shkak të ndryshimeve të shumta në terren ka qenë më se e nevojshme që të realizohet projekti i ri në vitin 2018. Objektivi kryesor i këtyre produkteve është të ofrojnë mbështetje në procesin e legalizimit të objekteve, planifikimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, mbrojtjen e ambientit, hidrografinë e demografinë, azhurnimin e hartës topografike, krijimin e hartave dhe skicave tematike të ndryshme si dhe shfrytëzimin e tokës në përgjithësi. Në Gjeoportalin Shtetërorë të qasshme për qytetarët janë 27 blloqe me ortofotot me rezolucioni 8 cm për të gjitha zonat urbane, ndërsa së shpejti pritet po në Gjeoportali të publikohen edhe ortofotot e të gjitha rezolucioneve të sipër përmendura të cilat janë në fazën e procesimit. Ortofotot mund të shikohen në gjeoportalin shtetëror, në

<http://geoportal.rks-gov.net/search>

# Takim i Komitetit Drejtues për të Drejta Pronësore



Nën organizimin e Ministrisë së Drejtësisë z. Abelard Tahiri, dhe me synim shpalosjen e të arriturave të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejta Pronësore, respektivisht për priorizimin e masave për zbatim gjatë vitit 2019 nga perspektiva e ndërlidhjes së të drejtave pronësore me Programin e Reformave Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 25 prill në Prishtinë është mbajtur takimi i Komitetit Drejtues për të Drejta Pronësore. Takimin në fjalë e ka hapur z. Tahiri i cili ka shpalosur sukseset e arritura në sektorin e të drejtave pronësore, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm në këtë Ministri z. Qemajl Marmullakaj ka prezantuar në detaje masat e dala nga plani i veprimit dhe zbatimin e këtyre masave. Pastaj po ashtu është diskutuar

rreth reformave që duhet ndërmarrë me qëllim avancimit të fushës së të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës. Në takim ku morën pjesë palë të interesit në fushën e të drejtave pronësore, u përfaqësua dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, respektivisht kreu i saj z. Avni Ahmeti. Z. Ahmeti ngriti dy çështje të rëndësishme, respektivisht kërkoi shtimin e kompetencave ligjore Komisionit për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale me qëllim të formalizimit të transaksioneve joformale dhe kërkoi përkrahje në shtyrjen para të ligjit të ri për kadastër. Po ashtu, dy çështjet e ngritura nga z. Ahmeti si dhe shtyrja para e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dolën edhe si rekomandime nga takimi i Komitetit Drejtues.





# IMPULS, aktivitetet e progresi



Agjencia Kadastrale e Kosovës bazuar me ligjet në fuqi është kompetente për koordinimin e Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore në Republikën e Kosovës. AKK ka identifikuar më shumë se 30 institucione shtetërore, të cilat prodhojnë më shumë se 70 grupe të të dhënave gjeohapësinore. Sipas direktivës INSPIRE parashihen që të harmonizohen 34 tema, të përfshira në 3 anekse, ku nga ana e grupeve punuese të Komisionit Evropian janë krijuar udhëzuesit për të gjitha temat, që në mënyrë specifike të tregohet se si të bëhet harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore dhe çfarë të harmonizohet, udhëzuesit mund të shkarkohen nga ueb-faqja: <https://inspire.ec.europa.eu/data-specifications/2892>



(Komiteti Drejtues i IMPULS)

Gjithashtu mbledhjes së këtyre të dhënave i kanë parapri edhe disa takime me zyrtarë përgjegjës për GIS në institucione të ndryshme private dhe shtetërore. Të dhënat gjeohapësinore nga secili institucion janë krijuar për nevoja të tyre duke ndjekur standarde lokale dhe si të tilla ato nuk janë zhvilluar në bazë të udhëzimeve që parasheh direktiva INSPIRE. Kryesisht, të dhënat gjeohapësinore para harmonizimit

kanë qenë të punuara në formate të ndryshme, ndërsa pas harmonizimit ato janë punuar sipas udhëzimeve dhe standardeve që parasheh direktiva INSPIRE. Konform direktivës INSPIRE gjatë projektit IMPULS janë analizuar dhe harmonizuar të dhënat për:

|                                            |
|--------------------------------------------|
| Zonat kadastrale                           |
| Parcelat kadastrale                        |
| Hidrografia                                |
| Transporti rrugor (në proces)              |
| Adresat                                    |
| Shpërndarja e popullsisë – Demografia      |
| Gjeologji (minierat aktive dhe jo aktive)  |
| Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve. |

Në mënyrë që të informojmë përdoruesit për informacionin hapësinor në dispozicion, ne kemi publikuar referencat në grupet e të dhënave ekzistuese dhe meta të dhënat në një katalog ku detajisht janë përshkruar pronarët e të dhënave, kontakti dhe mënyra e qasjes në ato të dhëna, si dhe janë krijuar shërbimet e shikimit dhe shkarkimit. Katalogu është një pjesë qendrore e procesit të shkëmbimit të informacionit dhe shpërndarjes së tij. Ndhmon përdoruesit të zbulojnë informacionin në mënyrë sistematike dhe efikase, për të kërkuar dhe zbuluar të dhëna dhe shërbime gjeografike të disponueshme në komunitetin gjeohapësinor. Katalogu përshkruan se çfarë janë meta të dhënat dhe sa janë të rendësishme për qasjen e të dhënave. Meta të dhënat gjeografike, të definuara si të dhëna për të dhënat gjeografike, paraqesin dokumentacionin e strukturuar

rreth bazave të të dhënave dhe shërbimeve hapësinore. Të cilat i ndihmojnë pronarët e të dhënave për të menaxhuar në mënyrë efikase informacionet e tyre hapësinore dhe lejon përdoruesit të gjejnë dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e përdorimit. IMPULS ka mbajtur disa punëtori në ambientet e AKK-së, ku është prezantuar gjeoportali shtetëror dhe gjeoserveri si dhe është demonstruar harmonizimi të të dhënave nga hidrografia. Pjesëmarrës në punëtori kanë qenë përfaqësues të të gjitha institucioneve, të cilat merren me të dhëna gjeohapësinore dhe përfaqësues ndërkombëtar.

Si dhe kemi zhvilluar kontakte të shumta me zyrtarë të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për të dhënat gjeohapësinore, ku jemi informuar rreth të dhënave gjeohapësinore që ata kanë në menaxhim dhe është bërë analizimi i atyre të dhënave. Janë krijuar datasete, meta të dhëna dhe shërbimet e shiqimit dhe shkarkimit për:

|                                                                                       |
|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Parcelat kadastrale                                                                   |
| Adresat                                                                               |
| Hidrografia (lumenjtë dhe liqenet)                                                    |
| Transporti rrugor (në proces)                                                         |
| Modeli digjital i lartësive                                                           |
| Emrat Gjeografik                                                                      |
| Njësit administrative                                                                 |
| Orto imazhet                                                                          |
| Gjeologji (vendburimet minerale, minierat aktive dhe pasive)                          |
| Shpërndarja e popullsisë (shpërndarja sipas komunave, shpërndarja sipas vendbanimeve) |
| Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve.                                            |

Ndërsa në Gjeoportali nga të dhënat e harmonizuara gjatë projektit IMPULS janë publikuar gjeologjia (minierat aktive dhe jo aktive), vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve.



(Moment nga një punëtori i IMPULS) gavlemars

# Bashkëpunimi i AKK me Open Street Map



Me qëllim të informimit të ndërsjellë mes procesit dhe progresit të futjes së të dhënave të adresave në platformën Open Street Map, si dhe identifikimit të fushave të interesit për bashkëpunimet e ardhshme, kreu i Agjencisë Kadastrale të Kosovë z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe eksperti nga njësia e adresave në AKK z. Amir Sogojeva kanë mbajtur një takim pune me përfaqësues të Open Street Map, respektivisht z. Guillaume Richard dhe z. Besfort Gurri. Përfaqësuesit e OSM njoftuan se 85% e të dhënave të emrave të rrugëve janë futur në platformën e OSM dhe procesi është duke vazhduar. Gjithashtu ata potencuan se kualiteti i të dhënave të adresave të marra nga AKK është shumë i mirë. AKK vlerësoi bashkëpunimin me OSM të cilin e konsideron si shumë të rëndësishëm. Gjithashtu AKK u shpreh e gatshme për bashkëpunim edhe në fusha tjera.



## Informata mbi AKK

AKK është organ kompetent për kadastër, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi, për sistem të adresave dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore

KRYESHEF EKZEKUTIV  
Avni Ahmeti  
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR  
Ismet Kryeziu  
Ismet.Kryeziu@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCËVE  
DHE ADMINISTRATËS  
Fazile Hamiti  
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT  
Afërdita Thaçi  
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS  
Korab Ahmetaj  
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË  
Ibadete Rexhepi  
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE  
INFORMATA TË PËRGJITHSHME  
akk@rks-gov.net

## Hidrosistemi Kikë-Kremenatë, diskutim publik

Nën organizimin e Kryetarit të Komunës së Kamenicës z. Qendron Kastrati, me pjesëmarrjen e Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi, përfaqësuesve të Bankës Botërore, Kryeshefit të AKK-së z. Avni Ahmeti, prijësve të institucioneve publike të interesit dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve të Komunës së Kamenicës, me datë 16 maj 2019, në ambientet e Kuvendit Komunal Kamenicës është mbajtur diskutimi publik rreth projektit "Hidrosistemi Kikë-Kremenatë". Në takim është prezantuar qëllimi i projektit, janë prezantuar përfitimet nga një projekt i tillë dhe sfidat eventuale gjatë implementimit të të njëjtit projekt. Ministri

i MMPH-së z. Matoshi në hapjen e takimit informoi qytetarët që pendat që do të ndërtohen në kuadër të këtij projekti do të jenë multi funksionale për shumë arsye sepse përveç sigurimit të ujit të pijes që është elementar për banorët e kësaj ane, të njëjtat do të ndihmojnë edhe zhvillimin e bujqësisë, turizmit dhe mundësi edhe

për investime tjera. Ndërsa kreu i AKK-së z. Avni Ahmeti në takim përgëzoi Komunën për përfitimin e këtij projekti, ndërsa nga ana e tij dhe institucionit të cilin udhëheq premtoi ndihmë si në ekspertizë po ashtu edhe në ofrim të gjeoinformacionit për nevoja të projektit në fjalë.

